



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Janë evidentuar mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë si investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret dhe Konfidencial nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin aktual ka shpenzuar rreth 96% të buxhetit final apo 201,826,135€. Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me kompensimin jo të plotë për punën jashtë orarit të pjesëtarëve të FSK-së, menaxhimin e kontratave që kishin të bënin me vonesat në furnizim/liferim të mallit dhe mangësitë në zbatimin e proceseve të prokurimit publik.

Po ashtu, mbetet ende sfida prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive nën 1000€ në PFV, pasi që është konstatuar nënvlerësim i tyre.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyra financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre, dy (2) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe tre (3) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik

Gjetja

Sipas Rregullores nr. 001/2022 të KRPP, konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Ky paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.; dhe

Neni 39 i LPP-së, për njoftimin paraprak, përcakton se “Kur një autoritet kontraktues ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të, një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej pesë qind mijë (500.000€), lidhur me secilën kategori të përmendur autoriteti kontraktues do të përgatisë njoftimin paraprak”.

Ne identifikua mangësi në aplikimin e procedurave të prokurimit si në vijim:

- Në nëntë (9) kontrata, menaxherët e kontratave nuk kanë mirëmbajtur/azhurnuar në mënyrë të rregullt menaxhimin e kontratave në sistemin elektronik të prokurimit sa i përket evidentimit të të gjitha pagesave të kryera; dhe
- Në gjashtë (6) procedura të planifikuara me vlerë individuale mbi 500,000€, identifikua se autoriteti kontraktues nuk kishte përgaditur njoftimin paraprak për dhënien e kontratave. Bazuar në informatat nga AK, praktika e njoftimit paraprak nuk ishte duke u aplikuar.

Mangësitë e evidentuara janë rezultat i mungesës së kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes adekuate. Po ashtu, mos menaxhimi i kontratave përmes platformës së e-prokurimit ishte edhe për shkakun e ndryshimeve të shpeshta të menaxherëve të kontratave.

Ndikimi

Mos menaxhimi përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave. Po ashtu, mosaplikimi i njoftimit paraprak ulë transparencën për operatorët ekonomik që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave, që të evidentohen në kohë reale të gjitha shënimet që lidhen me menaxhimin e kontratës (përfshirë edhe pagesat e kryera) në sistemin elektronik të prokurimit. Menaxheri i prokurimit duhet të sigurojë publikimin e njoftimit paraprak me qëllim rritjen e transparencës, dhe sigurimin e konkurrencës

ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 50,442,169€, prej tyre janë shpenzuar 50,440,597€ apo rreth 100%.

Çështja C1 - Kompenzimi jo i plotë për punën me kujdestari

Gjetja

Ligji për Pagat në Sektorin Publik nr. 08L-196 në nenin 36 paragrafi 1 përcakton se zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhën nga buxheti i shtetit përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare.

Ministria, për punën e kujdestarive ka paguar pjesëtarët e FSK-së, vetëm për muajin janar 2025. Po ashtu, kompenzimi me ditë pushimi, gjatë vitit është bërë për aq sa zhvillimi i aktiviteteve operative të FSK-së të mos ndikohet/pengohet. Ministria kishte bërë kërkesë në vazhdimësi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për ndarje të buxhetit shtesë për përmbushjen e obligimeve, por kjo kërkesë nuk kishte gjetur mbështetje. Bazuar në këto kërkesa vërehet se vlera e kujdestarive të papaguara për pjesëtarët e FSK-së për vitin 2025 kishte arritur 2,869,999€, dhe për shkak të mospagesës kishte filluar procesi i padive nga pjesëtarët e FSK-së ndaj Ministrisë.

Nëse analizohet buxheti i MM-së në kategorinë paga dhe shtesa ndërlidhur me paragrafi 3 të nenit 36 të Ligjit të Pagave që e kufizon vlerën e kompensimeve me vetëm 1% nga kjo kategori, situata në lidhje me kompensimin e kujdestarive bëhet komplekse për shkak që vlera vjetore e lejuar e kompensimeve bazuar në buxhetin e Ministrisë (Buxheti 50,442,169 x 1% = 504,421) as përfaqësohet nuk i përmbush kërkesat që i ka prezantuar Ministria. Paragrafi 4 i këtij ligji thekson se kufizimi prej 1% mund të tejkalohet vetëm me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2024 ministria kishte filluar plotësim ndryshimin e rregullores Nr.10/2019 për orarin e punës në FSK, ku pritej të adresohen çështjet specifike të FSK-së në lidhje me orarin e punës mirëpo as në këtë vit nuk është përmbyllë procesi i miratimit të rregullores.

Shkaku i mos kompensimit të plotë ishte mungesa e buxhetit. Tejkalmi i kufirit për kompensimet e punës shtesë, pa vendim paraprak të Qeverisë, përbën mospajtueshmëri me dispozitat e Ligjit.

Ndikimi

Kompensimi jo i plotë qoftë financiar apo me ditë pushimi paraqet rrezik që Ministria të ballafaqohet edhe më tutje me padi gjyqësore që do të kenë ndikim financiar duke shkaktuar edhe shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të shqyrtojë mundësinë e trajtimit të kësaj çështje në Qeveri për t'i dhënë drejtim të qartë kërkesave në lidhje me shtesat për të parandaluar paditë ndaj ministrisë që pritet të kenë kosto shtesë. Po ashtu, duhet përsheptuar procesi i rishikimit të rregullores aktuale për orarin e

punës dhe të kryhen analiza detaje për të gjetur modalitete që kompensimet shitesë për kujdestari të jenë brenda kornizës ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë ishte 41,361,988€, prej tyre ishin shpenzuar 38,720,295€ apo rreth 94%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me avanse për mbrojtje dhe siguri, karburant për vetura, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), furnizim me veshëmbathje, municion dhe armë zjarri e pajisje tjera.

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e barnave

Gjetja

Rregullorja e MF - së Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, në nenin 7 përcakton se të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare duhet të mbështeten në dokumente siç janë: fletë-pranimet, fletë-daljet dhe vetëm atëherë dokumentacioni do të konsiderohet i rregullt nëse dëshmohet me saktësi ndodhja e transaksionit dhe nëse përmban informata për shkakun e ndodhjes, datën dhe vendin e ndodhjes, llojin e pasurisë jo financiare, sasinë, vlerën dhe personat që kanë ekzekutuar transaksionin.

Edhe në vitin 2025 menaxhimi i depoz së barnave nuk është realizuar përmes sistemit e-Pasuria. Daljet e barnave drejt kampeve të tjera apo për pacientët nuk janë regjistruar në sistem, por janë evidentuar vetëm në formë fizike. Si rrjedhojë, gjendja e stokut të barnave në sistemin e-Pasuria nuk pasqyron lëvizjet reale dhe mbetet e pasaktë.

Po ashtu, barnat me afat të skaduar janë zhvendosur dhe po ruhen në një ambient më të përshtatshëm në regjimentin e mjekësisë në FSK, por menaxhmenti ende nuk ka ndërmarrë masa konkrete për asgjësimin e barnave.

Arsyeja pse nuk bëhet dalje e barnave nga e-pasuria nga moduli i spitalit ushtarak, është se depoja qendrore e FSK-së, ku pranohen të gjitha mallrat, nuk ka bërë dalje në modulin e e-pasurisë së spitalit ushtarak. Po ashtu, vlen të theksohet se Ministria është në proces të funksionalizimit të sistemit të brendshëm të menaxhimit të pasurive - MIMS, përmes të cilit pritet të adresohet edhe çështja e menaxhimit të barnave.

Ndikimi

Mungesa e informatave të sakta mbi gjendjen e stokut të barnave në depo, krijon një pasqyrë jo të qartë duke ndikuar edhe në planifikimet e ardhshme për blerjen e tyre.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të sigurojë se menaxhimit të barnave i paraprinë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke ofruar informata të sakta mbi gjendjen e stokut të barnave në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet menaxhohen përmes sistemit të menaxhimit të pasurive në mënyrë që të ketë pasqyrë të saktë të barnave në kohë reale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C3 - Vonesë në përmbushjen e kontratës

Gjetja Afatet dhe kushtet e liferimit të produkteve/mallit janë të definuara me kontratë dhe afati për dorëzim, do të llogaritet nga koha e lëshimit të urdhërbljes nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK). Në rastet kur Operatori ekonomik nuk arrin që t'i dorëzoj produktet, shërbimet ose punët sipas kushteve të kontratës AK do të ketë të drejtë që të aplikoj penalet.

Furnizimi me pajisje RST për nevojat e FSK-së, në vlerë 43,896€, është realizuar me vonesë prej 14 ditësh. Afati për liferimin e mallit ka qenë 60 ditë nga data e lëshimit të urdhërbljes (21.08.2025), ndërsa pranimi i mallit është bërë më 03.11.2025. Për këtë vonesë nuk janë ekzekutuar penalet.

Vonesa në liferim të mallit kishte ndodhur kryesisht si rezultat i menaxhimit jo të mirë të kontratës.

Ndikimi Vonesat në furnizim me pajisje reflektojnë në vështirësi operacionale për qëllimet e planifikuara të FSK-së në kohën e duhur dhe sipas kushteve të kontratës.

Rekomandimi C3 Ministri përmes menaxherëve përkatës, duhet të sigurojë përmbushjen e kontratave sipas afateve të përcaktuara. Po ashtu, duhet ndërmarrë veprime për aplikimin e penaleve kur vonesat janë evidente.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 305,379,927€, pasurive jokapitale është 1,389,783€, si dhe e stoqeve 6,493,279€.

Çështja A2 - Vonesa në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive

Gjetja

Sipas udhëzuesit për rregullat dhe procedurat e menaxhimit të pasurisë jo-financiare të Ministrisë së Mbrojtjes - Forcës së Sigurisë së Kosovës, përcaktohen afatet për përfundimin e proceseve përkatëse. Sipas pikës 36, komisioni i inventarizimit duhet që raportin e inventarizimit ta përgatisë më së largu deri më 25 dhjetor të vitit përkatës; ndërsa sipas pikës 42, komisioni i vlerësimit duhet ta përgatisë raportin e vlerësimit deri më 15 janar të vitit pasues.

Vonesa janë evidentuar si nga komisioni i inventarizimit ashtu edhe nga komisioni i vlerësimit. Komisioni i inventarizimit e kishte përgatitur raportin me datë 09.01.2026, kurse komisioni i vlerësimit, me datë 06.02.2026.

Raportet e përfunduara me kohë nga komisionet përkatëse janë të rëndësishme për të siguruar që gjendja e pasurisë jo-financiare të reflektohet në mënyrë të saktë dhe të plotë në pasqyrat vjetore financiare.

Vonesat e evidentuara në përpilimin e raporteve janë ndikuar nga kompleksiteti i organizatës buxhetore pasi që nëpër secilin regjion të FSK-së kryhen këto procese veçmas dhe në fund kemi një konsolidim, e që rrjedhimisht vonesa e një komisioni mund të shkaktojë vonesa edhe në raportet e konsoliduara. Po ashtu, vonesat ishin shkaktuar edhe nga ngarkesat në punë të zyrtarëve.

Ndikimi

Vonesat në përgatitjen e raporteve nga komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit rrisin rrezikun që gjendja reale e pasurisë jo-financiare të mos reflektohet me kohë dhe në mënyrë të saktë në regjistrat e pasurisë dhe në PVF, duke ndikuar në besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive i përmbahen afateve të përcaktuara me udhëzimet e brendshme për përgatitjen e raporteve, me qëllim që mangësitë e identifikuara në regjistrat e pasurive të evitohen para përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Dobësitë në menaxhimin e pasurive

Gjetja

Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 përcaktohet që "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga sistemi e-pasuria.

Neni 22, pika 3 përcakton që të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Po ashtu neni 24 pika 3 përcakton që paraqitja e pasurisë jo financiare në Pasqyrat vjetore financiare do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Ministria aktualisht nuk përdor sistemin e-Pasuria për menaxhimin e pasurive me vlerë nën 1,000€, pasi që është në proces të funksionalizimit të një programi të brendshëm (MIMS). Si rrjedhojë, regjistrimi në vitin aktual dhe menaxhimi i këtyre pasurive ishte bërë përmes regjistrave në Excel.

Ne identifikuam se pasuritë ishin të nënvlerësuara në PVF për 116,758€, si në vijim:

- Tre (3) pasuri nën 1,000€ (pajisje policore ushtarake dhe kositëse) me vlerë 19,180€, nuk ishin regjistruar në regjister kontabël përkatës;
- Tre (3) donacione të pranuar me vlerë 225,142€, nuk janë regjistruar në klasën përkatëse dhe në periudhën e pranimi, duke shkaktuar nënvlerësim prej 83,586€; dhe
- Në njëmbëdhjetë (11) raste të pasurive nën 1,000€, zhvlerësimi është llogaritur për tërë vitin, dhe jo duke filluar nga periudha e blerjes, duke shkaktuar nënvlerësim prej 13,992€

Për më tepër janë evidentuar edhe gabime teknike në emërtimin e pasurive si: një pajisje është paraqitur në PFV si fotokopje, ndërsa nga dokumentacioni mbështetës rezulton të jetë radio bazë (me të njëjtin barkod). Po ashtu, gjatë ekzaminimit fizik janë hasur vështirësi në identifikimin e pasurive, për shkak se regjistrat kontabël nuk përmbanin numrat identifikues të pasurive. Kjo ka vështirësuar gjurmueshmërinë e pasurive.

Mangësitë e identifikuar ishin si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme por edhe sfidat për të migruar pasuritë nga e-pasuria në sistemin e brendshëm MIMS për menaxhimin e pasurive.

Ndikimi

Regjistrimi jo i plotë dhe klasifikimi jo i duhur i pasurive ndikon në raportimin e vlerës së pasurive dhe menaxhimin e tyre. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të saktë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave dhe zyrtarëve të pasurive që të gjitha pasuritë janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Duhet shtuar kujdesi që gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive të korrigjohen në mënyrë që vlera e prezantuar e pasurive të jetë e saktë duke përfshirë edhe zhvlerësimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	207,875,243	210,411,297	201,826,135	169,781,668	177,943,593
Grante Qeveritare - Buxheti	207,875,243	210,411,297	201,826,135	169,781,668	177,943,593

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,536,054€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2025 Ministria ka shpenzuar 96% të buxhetit final, në vlerë financiare prej 201,826,135€, përdërisa vitin paraprak kishte realizuar 97% të buxhetit final. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	207,875,243	210,411,297	201,826,135	169,781,668	177,943,593
Pagat dhe mëditjet	47,425,383	50,442,169	50,440,597	42,353,950	36,754,944
Mallrat dhe shërbimet	45,344,600	41,361,988	38,720,295	41,666,736	51,294,124
Komunalitë	1,164,000	1,164,000	1,101,136	907,219	862,240
Investimet Kapitale	113,941,260	117,443,140	111,564,107	84,853,764	89,032,284

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 3,016,786€. Kjo rritje është bërë me vendime të Qeverisë për të mbuluar rritjen e koeficientit në paga, si dhe plotësuar mungesën e buxhetit në këtë kategori për muajin dhjetor. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është zvogëluar për 3,982,612€. Me miratimin e kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes, është realizuar transferi i brendshëm prej 3,756,400€ në kategorinë e investimeve kapitale, ndërsa pjesa tjetër prej 226,212€ është zvogëluar si rezultat i vendimeve të Qeverisë në kuadër të kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 94%;
- Buxheti final nga ai fillestar për shpenzime komunale nuk kishte ndryshuar. Realizimi i buxhetit ishte rreth 95%;
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 3,501,880€. Kjo rritje është rezultat i transferit të brendshëm nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 3,756,400€, ndërsa një zvogëlim i buxhetit prej 254,520€ është bërë si rezultat i vendimeve të Qeverisë në kuadër të kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 95%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Ministria në vitin 2025, pranimet i kishte në vlerë prej 104,600€ si në vijim:

- Pranimet në vlerë prej 1,345€ ishin realizuar nga gjobat në trafik, sipas Rregullores (MM), Nr.04/2023 për autorizimet e policisë ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës; dhe
- Pranimet nga viti i kaluar në vlerë prej 103,255€, e që kishin të bënin kryesisht me kthim të mjeteve nga pagesat ndërkombëtare në vlerë 91,027€, dhe kthim të mjeteve/pagave nga të punësuarit në vlerë 12,228€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	148,003	148,003	104,600	30,359	170,332
Të hyrat jo tatimore	148,003	148,003	1,345	25,105	
Të hyrat tjera	0	0	103,255	5,253	170,332

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. MM kishte përgatitur planin e veprimit (datë 08.07.2025) ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, ne kemi identifikuar se tre (3) rekomandime ishin zbatuar, një (1) rekomandim ishte përsëritur, dhe tre (3) ishin pjesërisht të zbatuara siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak


Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve përkatës që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për eliminimin e barrierave të ndryshme dhe krijimin e parakushteve për pranimin e mallit duke mundësuar përmbushjen e secilës kontratë sipas afateve të përcaktuara.	Janë bërë disa korrigjime, mirëpo prapë kemi identifikuar probleme në menaxhimin e liferimit të mallrave.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pagat dhe mëditjet	Ministri përmes menaxherit të personelit dhe komisioneve rekrutuese duhet të siguroj një proces të drejtë duke forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm në proceset e ardhshme të rekrutimit. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me ushtrues detyre me pozita të rregullta.	Këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla	I zbatuar

3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të përshpejtoj procesin e rishikimit të rregullores aktuale për orarin e punës duke i përshtatur me aktivitetin e saj dhe të sigurojë një rregullim të qartë në lidhje me kompensimin e punës jashtë orarit qoftë me pagesë apo me ditë pushimi në mënyrë që të gjithë pjesëtarët të cilët shërbejnë jashtë orarit të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ministria vetem për muajin Janar 2025, kishte bërë kompenzimin e zyrtarëve përderisa ende nuk kishte miratuar rregulloren lidhur me kompenzimin/pushimin.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitet	Ministri duhet të sigurojë se menaxhimit të barnave i paraprinë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke i shërbyer ata me informata të sakta mbi gjendjen e stokut në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet të bëhen përmes e-pasurisë në mënyrë që të ketë pasqyrë të qartë gjatë gjithë kohës në mënyrë që mos të ketë grumbullim të barnave jashtë afatit.	Janë ndërmarrë disa veprime, mirëpo gjendja mbetet pothuajse e njëjtë sa i përket menaxhimit të barnave.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit dhe komisioneve vlerësuese një proces vlerësim të drejtë të ofertave bazuar në kriteret e dosjes të tenderit dhe monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me validitetin e ofertave kur proceset e vlerësimit të tenderëve për arsye të justifikueshme zgjasin përtej afateve.	Këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që pasuritë nën 1000€ janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Po ashtu, Ministria duhet të ndërtojë një bashkëpunim efektiv me mirëmbajtësin e sistemit e-pasuria për eliminimin e gabimeve gjatë tërë vitit në mënyrë që sistemi e-pasuria të gjenerojë me saktësi pasurinë e regjistruar.	Edhe këtë vit kemi identifikuar raste të ngjajshme, meqenëse ministria është në proces të kalimit në sistemin e brendshëm të menaxhimit të pasurisë MIMS.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të sigurojë një kordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për Raportim Vjetor Financiar.	Këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit




Ajtene Llapashtica, Udhëheqëse e ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



Altina Selimi Palushi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit publik	Mos publikimit të njoftimeve paraprake për procedurat me vlerë mbi 500,000.00 €, sqarojmë se praktika e deritanishme ka qenë e bazuar në publikimin e planeve të prokurimit në platformën e E-prokurimit dhe në ueb-faqen zyrtare të MM, duke konsideruar se operatorët ekonomikë janë informuar lidhur me aktivitetet e planifikuara të prokurimit. Po ashtu duhet theksuar se për shkak të natyrës specifike të funksionimit të institucionit dhe projekteve që ndërlidhen me mbrojtjen dhe sigurinë, përveç planit publik të prokurimit i cili dërgohet në AQP, hartohet dhe aprovohet edhe plan i vecantë i prokurimit në pajtim me “Regulloren e QRK-se Nr. 03/2019, për Prokurimin për Qëllime të Mbrojtjes dhe Sigurisë” dhe “Udhëzuesin Operativ për Prokurimet për Qëllime të Mbrojtjes dhe Sigurisë”, pas aprovimit të buxhetit. Në këtë proces, projektet e klasifikuara dhe projektet me ndjeshmëri të lartë të sigurisë largohen nga plani preliminar i prokurimit dhe trajtohen sipas procedurave, kufizimeve dhe dispozitave përkatëse ligjore dhe administrative. Edhe kjo ka qenë një ndër arsye përse praktika e publikimit të njoftimeve paraprake, respektivisht planeve indikative, nuk është aplikuar në mënyrë të plotë gjatë periudhave të kaluara. Mos menaxhimi -raportimit dhe mos azhurnimit të plotë të menaxhimit të kontratave dhe pagesave përmes sistemit elektronik të E-prokurimit	Në lidhje me njoftimin paraprak ne kemi trajtuar vetëm çështjet që i përkasin procedurave të rregullta të prokurimit duke përjashtuar prokurimet e veqanta. Arsyetimet e ofruara nga entiteti, për ndryshimet e shpeshta të menaxherëve të kontratave, janë të përfshira te gjetja. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

	për disa kontrata: - sqarojmë se gjatë vitit 2025 ka pasur ndryshime të shpeshta të menaxherëve të kontratave, rotacione të stafit dhe ngarkesë operative e administrative, të cilat kanë ndikuar që në disa raste evidentimi i të dhënave të mos realizohet në kohë reale, megjithëse dokumentacioni, evidencat financiare dhe dëshmitë përkatëse lidhur me implementimin e kontratave kanë qenë të administruara dhe të dokumentuara.	
Kompenzimi jo i plotë për punën me kujdestari	Draft Rregullorja për orarin e punës gjatë vitit 2025 edhe pse është hartuar dhe finalizuar, nuk është miratuar për shkak të kufizimeve ligjore (Ministër në detyrë),	Arsyet e ofruara nuk e ndryshojnë gjendjen. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Mangësi në menaxhimin e barnave	Programi MIMS është në fazë të implementimit dhe pritet të ndikojë në përmirësimin e menaxhimit të barnave në të gjitha nivelet organizative.	Arsyetimet e ofruara veçse janë të përfshira në gjetje. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
Dobësitë në menaxhimin e pasurive	Sistemi e-Pasuria ka qenë jofunksional për pjesën e FSK-së që nga muaji shtator 2025. Si pasojë e kësaj, raportimi financiar dhe evidenca e pasurive është realizuar në mënyrë manuale përmes regjistrave në format Excel.	Arsyetimet e ofruara veçse janë të përfshira në gjetje. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
20.05.2026			
Klasifikimi dhe Klasifikimi	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.
03	47	810	2



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MBROJTJES / MINISTARSTVO OBRANE / MINISTRY OF DEFENSE	
Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.
2647	28
Data: Datum:	20.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane - Ministry of Defense

DATE/A:	13.05.2026
REFERENC-Ë:	3/256/2026
PËR/ZA/TO:	Zyrën Kombëtare të Auditimit Adresa: Lagja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi, 210 - Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ejup Maqedonci, Ministër i Mbrojtjes në detyrë
NGA/OD/FROM:	Gafurr DUGOLLI - Sekretar i Përgjithshëm - MM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër e Konfirmimit Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditimit të Përgjithshëm për vitin 2025 me nr. të prot 687 të datës 06.05.2026 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohemi pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet, si dhe kërkojmë të adresohen komentet e bashkëngjitura kësaj shkrese për të cilat vlerësojmë se duhet të merren në konsideratë edhe një herë nga ekipa e auditimit;
- Pas pranimit të Raportit final, do të perpilojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe duke ju përbajtur afate ve kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.